

VENDIM
Nr. 110, datë 9.3.2000

PËR NJË NDRYSHIM NË BUXHETIN E VITIT 2000 TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT, MINISTRISË SË PUSHTETIT VENDOR DHE TË MINISTRISË SË FINANCIVE

Në mbështetje të neneve 100, 159 dhe 163 të Kushtetutës, të neneve 3 dhe 10, të ligjit nr.8270, datë 23.12.1997, “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, të nenit 12, të ligjit nr.7776, datë 22.12.1993, “Për buxhetin lokal”, të nenit 24, pika 1, dhe nenit 29, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2000”, me propozimin e ministrit të Financave dhe të ministrit të Pushtetit Vendor, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në kuadrin e ristrukturimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe të aktit të nxjerrë nga kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, drejtoritë rajonale të këtij organi kalojnë në sistemin e Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Ministrisë së Financave, për të plotësuar strukturat e kontrollit.

2. Nga 166 punonjës të cilët i pakësohen Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas pikës 1 të këtij vendimi, 151 punonjës i shtohen Ministrisë së Pushtetit Vendor, sipas pasqyrës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe 15 punonjës i shtohen Ministrisë së Financave.

3. Për efekt të zbatimit të pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi në buxhetin e shtetit të vitit 2000 bëhen këto ndryshime:

a. Kontrollit të Lartë të Shtetit i pakësohen 22 000 000 (njëzetedy milionë) lekë, nga të cilat 15 599 000 lekë fond pagash, 3 189 000 lekë sigurime shoqërore dhe 3 212 000 lekë shpenzime operative.

b. Ministrisë së Pushtetit Vendor i shtohen 19 650 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e gjashtëqindpesëdhjetë mijë) lekë, nga të cilat 13 932 000 për pagat, 2 849 000 lekë për sigurimet shoqërore dhe 2 869 000 lekë për shpenzime operative.

c. Ministrisë së Financave i shtohen 2 350 000 (dy milionë e treqindpesëdhjetë mijë) lekë, nga të cilat 1 667 000 lekë për pagat, 340 000 lekë për sigurimet shoqërore dhe 343 000 lekë për shpenzime operative.

4. Inventari i pajisjeve, i mjeteve të transportit dhe mjediset e zyrave të degëve rajonale të Kontrollit të Lartë të Shtetit i kalojnë sistemit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Ministrisë së Financave, sipas marrëveshjes së lidhur ndërmjet tyre.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Pushtetit Vendor për zbatimin e vendimit. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

PASQYRA NR.1

Numri i punonjësve në Sektorët e Kontrollit në Prefektura

1. Prefektura Berat	8
2. Prefektura Dibër	10
3. Prefektura Durrës	10
4. Prefektura Elbasan	12
5. Prefektura Fier	12
6. Prefektura Gjirokastrë	10
7. Prefektura Korçë	12
8. Prefektura Kukës	12

9. Prefektura Lezhë	8
10. Prefektura Vlorë	10
11. Prefektura Shkodër	12
12. Prefektura Tiranë	15

Totali	131
---------------	------------

MINISTRIA E PUSHTETIT LOKAL	20
MINISTRIA E FINANCAVE	15